

Editorial/

TË LINDËSH EDHE NJË HERË

Nga hoxhë Sokol Kondakciu



Njeriu është një krijesë e përsosur e Allahut te Madhëruar dhe persosmëria e tij qëndron në faktin se ai është krijuar në një cikël dhe formë perfekte nga Krijuesi i Gjithdishëm. Në Kuran thuhet: “**Ne e krijuam njeriun në ciklin dhe formën më të përsosur**”. (Suretu Tin, 3.)

Edhe përse njeriu është një krijesë e bukur e Zotit, ai nuk është perfekt në vetveten e tij në lidhje me veprimet dhe aktivitetin e tij të përditshëm.

Kur njeriu vjen në këtë botë është shumë i paditur dhe shumë i pavetëdijshëm për procesin që po ndodh, po ashtu dhe për botën në të cilën ai ka ardhur. Edhe pse kështu, ai është paisur me shqisa dhe gjymtyrë të cilat do t'i mundësonin ambientimin e tij në këtë botë dhe të jetuarit një jetë normale.

Allahu i Madhëruar thotë për të në Kuran: “**Është Allahu Ai që ju nxjerr ju nga barqet e nënave tuaja dhe ju nuk dini asgjë (nga dituria) e ju paise me dëgjimin, shikimin dhe ndjenjat e tuaja me qëllim që ju të jeni falënderues (për këto mirësi)**”. Suretu El Nahl,78

Pavarësisht nga ky fakt, njeriu është në një transformim të vazhdueshëm deri kur arrin në momentin që edhe për të fillon e shkruhen dhe i quhen mëkatet. Kjo gjë tregon se njeriu në fakt është një krijesë me natyrë mëkatore dhe ai nuk ka për të qënë perfekt

asnjëherë në këtë drejtim. Ajo që kërkohet nga njeriu është të ndjekë udhëzimin hyjnor me të cilin u dërgua profeti Muhamed (a.s.) dhe të zbatojë sa të jetë e mundur urdhëresat dhe porositë kuranore dhe ato profetike, dhe nga ana tjetër të shmanget nga çdo gjë e ndaluar (haram) që sjell zemërimin dhe dënimin e Krijuesit tonë mbi ne.

E megjithatë njeriu mbetet gabimtar ose mëkatar dhe mëkatit që nuk e ka shmangur dot do të ketë mundësinë për ta shlyer me forma të tjera të ligjëruara në këtë fe madhështore, e cila ka sjellë një rrugëdalje për çdo ngushtim.

Një nga mënyrat e shlyerjes apo fshirjes së mëkateve është kërkimi i faljes nga Allahu pas çdo mëkati duke u penduar sinqerisht dhe totalisht. Thotë Profeti Muhamed (a.s.) “*Çdo bir i Ademit është mëkatar, por mëkatarët më të mirë janë ata që pendohen*”.

Një mënyrë tjetër për shlyerjen e gabimit është dhe ndjekja e mëkatit me një vepër të mirë, sepse vepra e mirë e fshin atë të keqen para saj. Në një porosi të profetit drejtuar një djaloshi në kohën e tij ai thotë: “*Pas një të keqeje menjëherë bëj një të mirë, ngase e mira e fshin të keqen ...*”.

Në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe ibadetet kryesore si falja e namazit dhënia e zekatit, agjërimi dhe kryerja e haxhit.

Faljen e namazit Profeti ynë e ka

krahasuar me një lumë në të cilin besimtari musliman lahet në të pesë herë në ditë dhe kështu që ai do të jetë shumë i pastër dhe larg papastërtisë. Pasi profeti Muhamed bëri këtë krahasim tha: “*Kështu janë pesë namazet, Allahu me to fal mëkatet*”.

Sa i përket sadakasë dhe zekatit ato janë shpëtim dhe ruajtje nga zjarri i Xhehenemit. I dërguari i Allahut thotë: “*Ruhu nga zjarri duke dhënë sadaka qoftë me një gjysëm hurme*”.

Në të njëjtën mënyrë vëpron edhe agjërimi, nëpërmjet të cilit besimtari musliman shlyen dhe fshin gabimet e tij. Profeti a.s. thotë: “*Kush Agjëron Ramazanin me bindje tek Allahu dhe besim të plotë (për shpërblimin e tij), atij do ti falen mëkatet e shkuara*”.

Sa i përket obligimit të Haxhit ai ka një specifike disi më të vecantë, ndoshta kjo për vetë natyrën dhe rëndësinë e tij, duke qenë se Haxhi është një obligim që bëhet një herë në jetë dhe njëkohësisht jo i lehtë për të gjithë. Allahu i Madhëruar i ka dhënë atij një specifike të vecantë. Nëpërmjet kryerjes së haxhit në mënyrë perfekte besimtari arrin të fitojë ende më shumë. Shpërblimi i një haxhi të mirë nuk është me dicka tjetër, por veçse me Xhenet. Dobitë e haxhit janë të shumta dhe ato janë të gërshtuara midis shpirtërores dhe materiales. I dërguari i Allahut Muhamedi (a.s.) na tregon në një hadith se haxhi nuk është vetëm fshirës i mëkateve por dhe i varferisë, ashtu sic transmetohet

në një hadith te saktë. Ndërsa në lidhje më faljen e mëkateve një haxh i kryer në mënyrën e duhur është falje totale e mëkateve. Nëse dikush mendon se gjatë jetës së tij ka shumë mëkate dhe se ato nuk mund të falen apo të shlyhen me diçka e ka gabim. Gjithmonë ka një rrugëdalje dhe Allahu i madhëruar ka hapur shumë dyer nëpërmjet të cilave mundësohet falja e mëkateve. Ato qëndrojnë të hapura gati deri në fund të jetës. Është mëse e vërtetë që në këtë botë ne nuk na jepet mundësia e kthimit prapa në kohë për të regulluar disa nga gabimet tona, por ne shpirtërisht na është dhënë një mundësi e tillë për t'i bërë ato korigjime. Është obligimi i haxhit që nesë kryhet në formën e duhur, ai udhëton me ne shpirtërisht drejt një riformatimi mëkatesh, në stacionin fillestar ku zbritëm për herë të parë, dita në të cilën lindëm.

Është shumë e habitshme por kjo është natyra e obligimeve islame që Allahu solli për ne dhe veçanërisht obligimi i haxhit përtë cilin Profeti (a.s.) thotë: “*Ai që kryen Haxhin dhe gjatë tij nuk bën mëkate e as zënka, do të kthehet prej tij si në ditën që e ka lindur nëna e tij*”.

Kështu që haxhi neve na e mundëson të lindim edhe një herë, të rilindim me shlyerjen dhe fshirjen e mëkateve për ta nisur nga e para rrugën e mbetur drejt kënaqësisë së Allahut të Madhëruar, drejt xheneve të begata të cilat janë përgatitur enkas për besimtarët e devotshëm.

Fq.3/ Oaz i shpirtit/ Haxhi, një adhurim me urtësi të madhe

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Fq.6/ Jurisprudencë/ Dispozitat e falimentimit në Islam

Fq.7/ Gruaja/ Gruaja nënë, moderniteti dhe edukimi i fëmijëve

Nga hoxhë Justinian Topulli

Fetva/

Investimi i pasurisë të zekatit

Burimi i fetvasë: Akademia Fik'but Islam me qendër në Mekë

Tema: Sesioni i pesëmbëdhjetë / vendimi i gjashtë

Data e publikimit: 4/11/1998 e.s - 15/7/1419 h.

Nxjerrja e zekatit të pasurisë duhet të bëhet në mënyrë të menjëhershme, duke e bërë atë pronë të përfituesve të atyre që e meritojnë zekatin, e këta njerëz është vetë Allahu Ai që i ka përcaktuar tekstualisht në Librin e Tij. Allahu i Lartësuar thotë: "Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirimimin e skllevërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." (Teube; 60). Për këtë arsye, nuk lejohet investimi i zekatit të pasurive për interes të përfituesve të tij, siç janë të varfrit, për shkak se ky veprim përmban ndalesa legjislative fetare, si p.sh: prishja e detyrimit të nxjerrjes në mënyrë të menjëhershme, shmangia e mundësisë që përfituesit e zekatit ta marrin atë në kohën kur bëhet e domosdoshme nxjerrja e tij, gjë e cila u shkon në dëm të tyre.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin të shumta mbi Muhamedin (alejhi salatu ue selam) mbi shokët dhe ndjekësit e tij dhe falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Burimi: <http://www.themowl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=146&l=AR&cid=11>

Përfitimi nga pasuritë e zekatit për ndërtimin e shkollave dhe spitaleve, në vendet evropiane dhe themelimi i fondeve të zekatit në këto vende.

Akademia Fik'but Islam me qendër në Mekë

Lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, bekimet dhe uratat më të mira qofshin për Profetin tonë, pas të cilit nuk ka më profet.

Këshilli i Akademisë së Fik'but Islam në sesionin e tij të nëntë, i mbledhur në godinën e Ligës Botërore Islame me qendër në Mekë, në periudhën ndërmjet 12 Rexheb 1406 h./22 Mars 1986 deri në 19 Rexheb 1406 h./ 29 Mars 1986, mori në shqyrtim sugjerimin e Akademisë së Studimeve të Fik'but për Evropën,

që është nën vartësi të "Këshillit të Lartë Botëror të Xhamive", si dhe të paraqitur nga sekretari i përgjithshëm dhe nënkryetari i këshillit, rreth çështjes se: A mund të përfitohet nga pasuria e zekatit për ndërtimin e shkollave dhe spitaleve në vendet evropiane?

Pas shqyrtimit dhe dëgjimit të fjalëve të anëtarëve të këshillit dhe diskutimeve të tyre, Këshilli vendosi t'i qëndrojë vendimit të tij në sesionin e tetë se, thirrja për tek Allahu dhe gjithçka që i vjen në ndihmë asaj dhe mbështet veprat e saj, hyn te kategoria "dhe në rrugë të Allahut". Kjo kategori është një nga tetë kategoritë ku jepet zekati, të cilat i ka përmendur Allahu në Librin e Tij (ajeti 60 sure Et-teube), duke u nisur nga fakti se xhahadi në Islam nuk kufizohet vetëm tek lufta me armë, por përfshin edhe xhahadin me propagandë, komunikimin e mesazhit islam dhe durimin në vështirësitë e tij.

Allahu i Lartësuar thotë -duke iu drejtuar të Dërguarit të Tij- për Kur'anin: "Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani)." (el-furkan: 52)

Po ashtu Profeti (alejhi salatu ue selam) thotë në një hadith të tij: "Luftojini idhujtarët me pasurinë, me veten dhe me gjuhën tuaj." Hadithi transmetohet nga Ahmedi, Ebu Daudi, Nesaiu, Ibn Hibani dhe El-hakim dhe është autentik (sahih).

Ky kuptim që përmendëm bëhet edhe më i fortë në kohën e sotme, më shumë se në çdo kohë tjetër, sepse muslimanët përballen me llojlloj sektesh, doktrinash dhe filozofi të kota, nëpër vendet ku ata jetojnë, me anë të mendimit dhe kulturës dhe jo nëpërmjet shpatës dhe topave, nëpërmjet institucioneve arsimore dhe shoqërore dhe jo nëpërmjet institucioneve ushtarake. Hekurin nuk e zbut vetëm se një hekur i ngjashëm me të.

Është e domosdoshme që propaganda e shejtanit të përballohet me thirrjen për tek Allahu, arsimiti i padrejtë duhet të përballohet me arsimin e drejtë, mendimi i mbushur me kufr duhet të përballë me mendimin e mbushur me islam, ashtu siç Ebu Bekri i tha Halidit: "Luftoju ata ashtu siç ata të luftojnë ty: shpatën me shpatë, heshtën me heshtë..."

Në kohën e sotme janë shtuar shumë mjetet dhe metodat e thirrjes dhe ato nuk kufizohen vetëm tek fjala e folur, tek fletushkat që ndahen apo tek librat që shkruhen, ndonëse të gjitha këto janë të rëndësishme, por mjeti që ndikon më tepër dhe më i rrezikshëm sot, është bërë shkolla, e cila formon mendësinë e brezit të ri, shijet dhe prirjet e tyre. Shkolla mbjell te ta idetë dhe vlerat që dëshiron, po kështu edhe spitalet që presin të sëmurët, të cilat përpiqen të ndikojnë te njerëzit në emër të shërbimit human.

Këto mjete i kanë shfrytëzuar armiqët e Islamit, të tillë siç janë misionarët e kryqëzatave dhe të tjerë

si ata, për të luftuar ideologjikisht bijtë e umetit islam, për t'i zhveshur ata nga personaliteti dhe identiteti i tyre, për t'i devijuar ata nga besimi i tyre. Ata kanë ngritur shkolla, spitale dhe institucione të tjera për këtë qëllim dhe kanë shpenzuar për to para me dhjetëra dhe qindra miliona. Janë muslimanët më së shumti dhe në veçanti brezi i ri, ata që përballen me këtë rrezik, kur ata ndodhen jashtë vendeve islame.

Duke u nisur nga këto që thamë Këshilli vendosi se, organizatat arsimore dhe ato sociale, siç janë shkollat dhe spitale të ngjashme me to, nëse janë në vende joislame, konsiderohen sot si domosdoshmëri e thirrjes islame dhe si mjete të përpjekjes në rrugë të Allahut. Këto mjete e mbështesin thirrjen islame dhe i vijnë asaj në ndihmë, madje ato janë të domosdoshme për të ruajtur besimin e muslimanëve dhe identitetin e tyre fetar, përballë ofensivës ideologjike dhe doktrinale që ndërmarrin shkollat, qendrat dhe komplekset ateiste apo të feve të tjera, me kusht që këto organizata të jenë tërësisht islame, të themeluara me qëllimin e thirrjes islame dhe përcimit të mesazhit islam dhe në dobi të muslimanëve dhe jo për qëllime tregtare, individuale apo të një grupi njerëzish.

Për sa i përket themelimit të fondit të zekatit, për mbledhjen e tij nga ata që e kanë për detyrë dhe shpenzimi i tij në kategoritë e përcaktuara nga feja, një prej të cilave është edhe ajo që përmendëm më lart, është një gjë e lavdëruar fetarisht, sepse nëpërmjet tyre realizohen interesa të qarta të muslimanëve. Kusht për këtë gjë është që njerëzit që merren me këtë punë të jenë të besueshëm, njohës të dispozitave fetare sesi nxirret zekati dhe sesi shpërndahet ai.

Allahu e di më së miri. Allahu është mbarëvajtësi i suksesit. Paqja, bekimi dhe uratat më të mira qofshin për zotërinë tonë Muhamedin, familjen dhe shokët e tij. Allahut, Zotit të botëve, i takon lavdërimi për çdo gjë.

Pjesëmarrësit që ranë dakord

Kryetari i Këshillit të Akademisë së Fik'but:

Abdulaziz ibën Abdullah ibën Baz

Nënkryetari:

Dr. Abdullah Umer Nesif

Anëtarët:

Dr. Talal Umer Ba-fekih
Abdullah ibën Abdurrahman Al Basam

Mustafa Ahmed Ez-zerka
Muhamed Mahmud Es-sauaf
Salih ibën Uthejmin
Muhamed Esh-shadhili En-nufejr
Ebu Bekr Xhumi
Dr. Ahmed Fehmi Ebu Nieh
Muhamed El-habib ibën El-huxheh

Dr. Jusuf El-kardau
Muhamed ibën Salim ibën Abdul Uedud
Ebul Hasan Ali El-hasen En-nedeui

Burimi: <http://www.themowl.org/Home.aspx?l=AR>

Kushti për mos kthimin e parave të mallit të blerë

Komisioni i Përbershëm i Fetvave në Mbretërinë e Arabisë Saudite
Vëllimi 13
Fetva nr. 19804

Pyetje: Çfarë mendoni – Allahu ju begatoftë- rreth asaj që bëjnë disa tregtarë, të cilët bëjnë marrëveshje me blerësin se ka të drejtë që ta kthejë mallin, por nuk ka të drejtë që të marrë paratë, por duhet që të zgjedhë nga mallrat e tjerë që gjenden tek shitësi dhe që korrespondojnë me vlerën e mallit të kthyer. Nëse blerësi nuk e gjen mallin që dëshiron, atëherë shitësi e regjistron shumën blerësit në mënyrë që të kur të dëshirojë diçka nga dyqani mund ta marrë duke shfrytëzuar shumën e depozituar tek shitësi?

Përgjigje: Lejohet vendosja e kushtit për prishjen apo vazhdimin e shitblerjes për një periudhë të caktuar dhe blerësi ka të drejtë që ta kthejë mallin brenda këtij afati të paracaktuar, sipas marrëveshjes për kthimin e mallit dhe të marrë paratë që ka paguar tek shitësi, sepse ato janë paratë e tij. Ndërsa vendosja e kushtit për mos-kthimin e parave dhe që me to të blihet një mall tjetër nga shitësi, ky është një kusht i pavlefshëm dhe nuk lejohet që të veprohet me të. Argument për këtë thënia e të dërguarit të Allahut (alejhi salatu ue selam) "Çdo kusht që nuk është në librin e Allahut është i pavlefshëm edhe nëse janë njëqind kushte."

Allahu i mbështetemi. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e tij.

Burimi: <http://www.alifta.net/Fatawa/FatawaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4747&back=true>



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة البانيا
The Albanian Imam's League



www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri

lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Oaz i shpirtit/ Haxhi, një adhurim me urtësi të madhe

Nga hoxhë Mustafa Tërnici

Faja Islame është ndërtuar mbi pesë shtylla, nëpërmjet të cilave myslimani tregon përlulesinë dhe nënshtrimin e tij ndaj Zotit që e krijoi, Allahut të Plotfuqishëm.

Adhurimi i Allahut nuk është thjesht një detyrë, dobia e së cilës kthehet te vetë njeriu, për të shpëtuar nga zjarri, Ditën e Gjykimit. Në të vërtetë adhurimi përputhet bukur me Fitran e njeriut dhe nevojën që ka ai për të qenë afër të Plotfuqishmit kudo dhe kurdo. Adhurimi është udhëzim për mendjen, gjallëri për trupin, energji për zemrën dhe ushqim për shpirtin. Adhurimi është dritë për besimtarin dhe ngritje e tij në një stad më lart për përsosjen e moralit të tij gjë të cilën e vërejm fare mirë tek Haxhi.

Sipas shariatit islam me Haxh kuptojmë vizitën e Qabesë, (Kabes) në Mekë në një kohë të caktuar, sipas disa rregullave të caktuara për hir të Allahut të Madhërishtëm. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: **“Vizita (haxhi) në Shtëpinë (e shenjtë, Kabe) është detyrë për njerëzit që kanë mundësi ta kryejnë atë. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.”** (Ali Imran, 97.)


Haxhi është një nga shtyllat mbi të cilat është ndërtuar Islami, një adhurim i veçantë dhe tepër madhështor. Haxhi konsiderohet si kongresi vjetor i muslimanëve nga e gjithë bota. Gjithashtu haxhi është tubimi dhe manifestimi më i madh paqësor në botë, gjë e cila përsëritet në syrin e botës çdo vit, duke i lënë njerëzit të mahnitur tek shikojnë nënshtrimin dhe përkushtimin e muslimanëve dedikuar Krijuesit të tyre, Allahut të Plotfuqishëm.

Mos të harrojmë se Qabeja ku

haxhinjtë shkojnë është simboli i vetë adhurimit, sepse shtylla e islamit, namazi lidhet ngushtë me Shtëpinë e Shenjtë në Mekë. Kjo sepse të gjitha namazet, farze apo nafile qofshin falen duke u drejtuar pikërisht në drejtim të Qabesë. Për këtë arsye Qabeja quhet kibleja (drejtimi) i muslimanëve anembanë botës. Pra besimtari e ka të lidhur zemrën e tij ngushtë me Mekën dhe Qabenë e shenjtë që ndodhet aty. Madje, Allahu i Madhëruar e ka lidhur dashurinë ndaj Qabesë me vetë fitran e besimtarit, sepse të gjithë muslimanët, kudo qofshin ata kanë një dëshirë të zjarrtë për ta vizituar atë vend të shenjtë. Pra Shtëpia e Shenjtë, Qabeja është një vend që tërheq në formë magnetike të gjitha zemrat dhe shpirtat e besimtarëve dhe kjo ndodh vetëm me muslimanët.

Është e vërtetë që Haxhi kërkon durim, përkushtim dhe mund. Askush nuk mund ta kryejë këtë rit të shenjtë pa u lodhur, mirëpo ky adhurim i veçantë lë gjurmë dhe një ndikim tepër të thellë në shpirtin e besimtarit. Madje mund të themi se nëpërmjet këtij riti muslimani ripërtërit jetën e tij. Jo më kot i Dërguari i Allahut, Muahmedi (alejhissalatu uesselam) ka thënë: *“Kush bën haxh në Shtëpinë e Shenjtë duke mos folur me fjalë të ndyra dhe duke mos bërë mëkate, do të kthehet sikur të ishte në ditën që e ka lindur nëna e tij.”* Transmetuan Buhariu dhe Muslimi. Pra do të kthehet në shtëpi i pastër me gjynahe të falura.

Haxhi gjithashtu është një institucion i vërtetë edukimi shpirtëror dhe fizik me vlera të larta shoqërore. Me kryrjen e këtij riti fetar kurohen sëmundjet shkatërruese të zemrës. Aty fitohet durimi, përkushtimi, vëllazërimi,



solidariteti, toleranca, mëshira dhe mbi të gjitha, barazia mes njerëzve. Në Haxh mblidhen miliona njerëz nga e gjithë bota, të cilët paraqiten të barabartë pa dallim race, ngjyre, vendi, posti apo pozite. Të gjithë veshin një uniformë dhe që të gjithë lëvizin, veprojnë e zbatojnë të njëjtat rite. Bota nuk ka njohur ndonjëherë ndonjë sistem, rregull apo metodë të veçantë që mund të bashkojë dhe sistemojë me përpikmëri miliona njerëz me rraca, vende, gjuhë dhe kultura të ndryshme nga njëri tjetri. Paradat më të mëdha ushtarake ose kulturore në botë, jo vetëm që zhvillohen me numër të kufizuar pjesmarrësish, por me stërvitjet e tyre disa mujore ndryshojnë nga manifestimi i haxhit pasi dhe pjesmarrësit nëpër parada janë njerëz të zgjedhur që kanë një gjuhë dhe një kulturë të përbashkët. Kurse haxhinjtë tre apo katër milionë, të cilët kanë gjuhë të ndryshme, të papërgatitur më parë dhe të panjohur me njëri tjetrin i bashkon një gjë e vetme, Teuhidi

(njësimi) dhe adhurimi i Allahut të Plotfuqishëm.

Udhëtimi për në Mekë nga e gjithë bota, simbolizon udhëtimin e njeriut nga kjo botë në tjetrën. Veshja e ihramit të bardhë pa mëngë dhe qepje tregon për përlulesinë dhe robërinë para Allahut Fuqipotë. Gjithashtu ihrami i bardhë simbolizon veshjen e qefinit dhe daljen nga kjo botë pa marrë gjë me vete, sepse në botën tjetër nuk vlen asgjë nga kjo botë përveç punëve të mira. Rrotullimi rreth Qabesë simbolizon nënshtrimin ndaj Krijuesit Suprem dhe se udhëtimi ynë drejt ahiretit do të përfundojë më sukses nëse tregojmë nënshtrim dhe përpikmëri në adhurim ndaj Allahut të Madhëruar. Mbledhja dhe tubimi i të gjithë njerëzve në Arafat simbolizon paraqitjen tonë përpara Allahut Fuqipotë në Ditën e Gjykimit ku do të japim llogari për gjithçka që kemi vepruar. Lum ai besimtar që arrin kënaqësinë e vërtet shpirtërore në këtë botë nëpërmjet këtij adhurimi madhështor.

Cikli i haditheve të dobëta dhe të trilluara

Nga hoxhë Mustafa Tërnici

Nga libri: 110 Virtyte të Imam Aliut ...Vijon nga numrat e kaluar...

HADITHI NR 13:

Transmetohet nga Amr ibn Ebi Selemeh, djali i gruas së Profetit (a.s.), Ummi Selemeh, se kur mbi Profetin (a.s.) zbriti ajeti “Allahu dëshiron të largojë tërë ndytësinë (e mëkateve) nga ju, o Ehl ul-Bejt, dhe t’ju pastrojë me një pastrim të plotë” në shtëpinë e Ummi Selemes, ai (a.s.) thirri Fatimenë, Hasanin e Huseinin, dhe i mbuloi ata me një mbulesë (kisa). Aliu ishte pas tij dhe Profeti (s) e mbuloi edhe atë me ta. Atëherë, ai (a.s.) tha: “O Allah! Këta janë Ehl-i Bejti im. Largoje tërë ndytësinë e mëkateve prej tyre dhe pastroji ata me një pastrim të skajshëm!” Ummi

Selemja tha: “A jam unë mes tyre, O i Dërguari i Allahut! Ai u përgjigj: “Ti ke pozitën tënde dhe je në të mirë.”

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij nr. 3205 dhe po aty tregon se ky transmetim është i dobët me fjalën e tij të njohur “Garib” ku ka për qëllimin dobësimin e transmetimit. Për këtë arsye shikojmë në zinxhirin e transmetuesve të jetë Muhamed ibn Sulejman ibn el-Asbahani të cilin e kanë cilësuar si të dobët shumë shkenctarë të hadithit.

HADITHI NR 14:

Sipas Enes Ibn Malikut, i Dërguari i Allahut (a.s.) për gjashtë muaj me radhë kalonte pranë derës së Fatimesë çdo herë që dilte për të falur sabahun, dhe thonte: “Namazi, namazi, o Ehlul-

Bejt! “Allahu dëshiron të largojë të gjithë ndytësinë e mëkateve nga ju, o Ehl ul-Bejt, dhe t’ju pastrojë me një pastrim të skajshëm”.

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij nr. 3206 dhe po aty tregon se ky transmetim është i dobët me fjalën e tij të njohur “Garib” ku ka për qëllimin dobësimin e transmetimit. Për këtë arsye shikojmë në zinxhirin e transmetuesve të jetë Alij Ibn Zejdi të cilin e kanë konsideruar të dobët shumë dijetarë të hadithit, madje duke ia braktisur transmetimet që ai përcjell për shkak të gabimeve të shumta.

HADITHI NR 15:

Nga Ebu Sa’id el-Khudriu transmetohet se ka thënë: “Kur u

shpall ajeti **“Dhe urdhëroje familjen tënde të falë namaz...”** (20:132), Profeti (a.s.) për tetë muaj me rradhë, në vaktin e sabahut, vinte tek dera e Aliut dhe thonte: “Erdhi koha e namazit, Allahu ju mëshiroftë! “Allahu dëshiron të largojë tërë ndytësinë e mëkateve nga ju, o Ehl ul-Bejt, dhe t’ju pastrojë me një pastrim të skajshëm”.

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Ibn Asakir në “Tarih Dimeshk” 42/136 dhe të tjerë, por në zinxhirin e transmetuesve ndodhet Atijeh ibn Sa’d el-Aufi të cilin e kanë bërë të dobët në transmetimet e tij Imam Muslimi dhe të tjerë.

Vijon në numrin e ardhshëm...

Histori/ CIVILIZIMI ISLAM DHE POZITA E TIJ NË MESIN E CIVILIZIMEVE TË TJERA

Nga hoxhë Bilal Shkrepi

Historiani i njohur Arnold Toynbee ka konstatuar se njerezimi ka kaluar në më shumë se njezet civilizime, të gjitha janë shuar ose janë drejt shuarjes. Nderkohe që faktoret e shuarjes së tyre mbeten, luftërat dhe perplasja mes klasave.

Nese do të permendim disa prej këtyre civilizimeve, mbase me të njohurit për të cilët disponojmë informacione me shumë se për të tjeret, do të veconim; civilizimin helenik, faraonik, romak, pers, si edhe civilizimin modern.

Eshtë e vështirë të gjykojmë cdo njerin prej civilizimeve pa patur njësi matëse mbi bazën e të cilit krahasohen, nderkohe që njerezit do të kenë mosperputhje në percaktimin e këtyre njësive matëse. Le të themi se njësia matëse për të bërë krahasimin midis civilizimeve mund të jete si më poshtë:

1- Të jete civilizim "human" në qellimet, vlerat si edhe praktikën e tij.

2- Të jete civilizim, që kontribuojnë në ekzistimin dhe rinovimin e tij shumica e shoqërisë, pra të jete "civilizim popullor" e jo civilizim patriarkesh, faraonësh, apo forcash politike a ushtarake.

3- Shoqëria të gëzojë të gjitha mundësitë që të perfitojë prej gjithë shanseve që ofrohen.

4- Të synojë krijimin e mundësive të reja të cilat gëzojnë mundësinë e realizimit.

5- Të ketë mundësinë e rezistencës ndaj elementeve të zhdukjes apo rënies, si edhe të jete "civilizim i vazhdueshëm i rinovueshëm".

Nese do t'i praktikojmë këto kritere në krahasimin ndërmjet civilizimeve mbase do të kishim një gjykim të drejtë në krahasimin mes tyre.

Nese do të marrim si shembull civilizimin e fundit mund të themi se civilizimi modern karakterizohet nga elementi i trete dhe i katërt në masë të konsiderueshme, sikurse karakterizohet disi prej elementit të dytë, mirepo nuk është aspak e mbrojtur nga elementet e zhdukjes, sic thote Arnold Toynbee: "Tashmë gjendemi përballë realitetit se civilizimi ynë nuk është i mbrojtur prej shperberjes. Nuk e imagjinoj dot sesi mund të behemi të verber përballë këtij realiteti" (Civilization on Trial, p. 38.)

Civilizimi modern vështirë të cilesohet "human" pavarësisht lehtësimeve materiale që ka mundësuar në jetë, si edhe vlerave e moralit që ka shpalosur nepermjet slloganeve, si psh; liria, barazia, të drejtat e njeriut dhe vullnetarizmi. Ky civilizim pa asnjë dyshim nuk e ka bërë jetën të lumtur, qoftë edhe në vendet që e kanë prodhuar e promovuar. Njeriu i ndikuar prej civilizimit modern jeton me shumë prapë stresit dhe depresionit, sesa prapë kenaqesise, apo mjaftueshmërisë.

Vrasja e njeqindmijë njerezve brenda një nate si pasoje e hakmarrjes dhe e mllëfit, si edhe shkatërrimi i qytetit të Dresdenit brenda një nate, për të njejtin motiv, vështirë se na lejon të themi se një gjë e tillë ka ndodhur

si pasoje e iluminimit, arsytimit, civilizimit, apo humanizmit. Ndaj fillimisht e shkuar i këtij civilizimi me luftra, ska nevojë të permendet.

Mirepo c'ndodh me civilizimin Islam? A ekziston realisht civilizimi Islam? A mund të krahasohet në rrafsh civilizimi dhe perparimi me civilizimet e siperpermendura duke përfshirë edhe civilizimin modern?

Pothuajse cdo studiues në fushën e kultures islame, musliman qoftë a jomusliman asnjëherë, kur kanë folur për kulturen islame, janë përqendruar rreth institucionit "Darul Hikme" apo personaliteteve si El-Farabi, Er-Razi, Ibni Sina apo Ibni Rushdi, apo ndertesa arkitekturore, si Al-Hamra apo Taxh Mahali.

A është ky i gjithë civilizimi Islam? A thua janë dashur shumë germime derisa u shfaqën këto xhevahire të cmuara të civilizimit dhe perparimit? Apo këto janë praktikën me të spikatura të civilizimit Islam?

Vihet re se studiuesit e historisë nuk i kushtojnë rendesi civilizimit Islam si një civilizim i plotë dhe harmonik e nuk janë treguar të kujdeseshëm me shembujt e regjistruar në librat e trashgimisë historike në raportet mes muslimaneve dhe jomuslimaneve që jetonin në shtetin Islam.

Dekreti i shkruar prej Khalid bin Welidit për banorët e Irakut, në të cilin thuhet: "Cdo person në moshe, i pafuqishëm për punë, apo i semurë me cdo lloj semundje, apo që varferohet pasi ka qenë i pasur dhe fillon të jetojë me lemshen e njerezve të besimit të tij, clirohet prej taksave si edhe i sigurohet jetesa atij edhe familjes së tij prej Shtepisë së Pasurisë, për aq kohë sa jetojnë në shtetin Islam. Nese vendosin të jetojnë jashtë shtetit Islam, atehere muslimanët nuk kanë me asnjë detyrim të sigurojnë jetesën e tyre dhe të familjes së tyre" (Ebu Jusuf El-Kharaxh fq 144.)

Halifi Omer bin Abdulaziz nxorri dekret: "T'i sigurohet jetesa prej Shtepisë së Pasurisë, cdo jomuslimani i cili mbush moshën e pleqerisë, apo behet i paafte për punë, apo nuk i mjaftojnë të ardhurat" (Ibni Selam "El-Emual 45-46")

Këto janë disa prej shumë shembujve që tregojnë sistemin e pergjithshëm i marrë prej ligjit të shariatit, ligj të cilin kanë zbatuar muslimanët.

Shumekush prej studiuesve perserit ngjarjen e femres që i beri oponente halifit Omer, si argument për opozitarizmin popullor ndaj qeverisë si edhe për lirinë e mendimit dhe s'permendin një ngjarje të rendesishme dhe percaktuese në kohën e Omerit, kur sahabet u ndanë në dy grupe, grupi i Omer ibni El-Hatabit dhe Bilal ibni ebi Rabah dhe grupi i tij. Debati u ndez aq shumë midis halifës dhe opozitareve, të cilët me forcën e tyre opozitariste bene që Omeri të thonte: "O Allah më ndihmo ndaj Bilalit dhe shokeve të tij si të deshurosh." Mendimi Omerit fitoi, ndersa faktet historike s'te lenë të kuptosh ekzistencën e ndonjë arsyeje tjetër për triumfin e mendimit të tij vetëm se për shkak të zerave me të shumta. Kjo ngjarje skalit fuqishëm një dimension politik thelbesor që



bindja ndaj qeveritarit nuk është absolute, por në të mirat e pranueshme prej shoqërisë. Gjithashtu vendimet e dala prej qeverisë mund të rishikohen dhe t'u behet oponente, sepse në Islam çeshtjet zgjidhen me konsulte.

Një tjetër dimension i rendesishëm në politikën e pergjithshme shpaloset edhe në sistemin ekonomik i cili është zbatuar pergjate shekujve dhe si pasoje e tij është bërë i mundur harmonizimi ndërmjet sektorit publik (nepermjet të cilit shteti rregullon administrimin e pronave publike) dhe atij privat duke i garantuar individit të drejtën e pronës si edhe motivimin për të fituar dhe rritur kapitalin.

Njerezimi pergjate dyqind viteve të fundit, prej kohës së Adam Smithit deri më sot, nuk ka mundur të harmonizojë politikën ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, në mënyrë që t'i garantojë ekonomisë zhvillimin si edhe drejtësinë për të gjithë.

Ndërmjet shtetit Islam dhe Perandorisë Romake nuk ka asgjë të përbashkët, sepse qellimet dhe motivet e cdonjerës prej tyre ishin diametralisht të kundërta. Perjashtojë realitetin se cdonjera prej tyre u shtri duke përfshirë territore, toka dhe popuj të ndryshëm.

Ato ndryshojnë edhe për nga shpejtësia dhe ngadalesia e shtrirjes dhe përhapjes. Nderkohe që Perandorisë Romake iu deshën afersisht një mijë vjet për të arritur kulmin e shtrirjes së saj gjeografike dhe politike, shtetit të parë Islam nuk iu desh më shumë se tetëdhjetë vjet për të arritur kulmin e shtrirjes së tij. Dallimi midis tyre në aspektin e dobësimit është edhe më i qartë, sepse Perandoria Romake pas migrimeve të fiseve Hunë dhe Gotë ra përfundimisht pergjate një shekulli e nuk mbeti prej civilizimit të saj vetëm se disa vepra arti dhe arkitekturore. Ndersa shteti Islam ekzistencës së tij të gjatë, sidomos me ndryshimet e pushtetit nga një familje në tjetër, u deshën afersisht një mijë vjet deri në rënien e tij të plotë politike.

Kemi edhe një tjetër dallim ndërmjet dy perandorive. Nderkohe që Perandoria Romake ngrihej mbi forcën e luftës dhe shfrytëzimin e popujve të tjerë për interes të vendit mëmë si dhe për të realizuar një jetë me të mirë për aristokracinë romake, në perandorinë Islame nuk i jepej prioritet ndonjë etnie ndaj etnive të tjera, ndersa fuqia

e perandorisë bazohej në besimin tek Zoti Një dhe vihej në funksion të përhapjes së këtij besimi.

Shkrimtari dhe historiani i njohur anglez H.G Wells në librin e tij "Outlines of The History" thote: "Drejtësia romake ishte vetëm për romakët, nderkohe që për pjesën tjetër vështiresitë, vuajtjet dhe padrejtësitë s'kishin as kufi e as kush i parandalonte", ka thënë gjithashtu se: "Gjeja që më së shumti terhoqi zemrat e njerzve drejt Muhamedit dhe fese Islame ishte koncepti i adhuruarimit të Zotit Një dhe askujt tjetër vec Tij, gjë e cila ngacmoi natyrshmerinë e zemrave ... Pasi e pranuan Islamin dhe sistemin e tij në mënyrë të sinqertë përpara tyre u hap porta e gjere e vëllazërisë njerzore të cilën duhej ta kultivonin deri në momentin e hyrjes në Parajsë vend të cilin nuk e zotërojnë shenjtorët e as mbreterit. Hyrja dhe gradet e tyre në Parajsë nuk vareshin nga simbolika të paqarta e as nga rite të errëta, por nga devocioni. Muhamedi ia ofroi këto sisteme moral zemrave dhe Islami mundësoi ekzistencën e një shoqërie që u clirua prej shtypjes dhe diskriminimit social në ato grada të cilat s'ka mundur t'i arrijë asnjë shoqëri tjetër."

Filozofi, historiani dhe shkrimtari i njohur amerikan William Durant në librin e tij "The Story of Civilization" thote: "Hebrenjtë në lindjen e afert, i mirpritën arabët të cilët arritën t'i clironin prej padrejtësisë së pushtetareve të parë... fituan gjithë të drejtat në jetën e tyre dhe praktikimin e fese së tyre... nën hijën e shtetit Islam arritën të venë pasuri të madhe, si në Azinë e vogël, Egjipt po ashtu edhe në Spanjë, pasuri të cilën nuk arritën ta venë nën hijën e pushtetit të krishterë."

Të krishterët në vendet e Azisë perëndimore gëzonin të drejtat të plotë në praktikimin e fese së tyre. Historianët na kanë treguar se në kohën e halifit Me'mun ndodheshin në vendet Islame mbi njembdhjetë mijë kisha, shumë sinagoga si edhe faltore ku adhurohej zjarri. Të krishterët ishin të lire të festonin festat e tyre publikisht, sikurse edhe pelegrinët e krishterë vizitonin të sigurt vendet që i konsideronin të shenjta në Palestinë.

Vijon në numrin e ardhshëm...

Agjërimit përtej Ramazanit

Nga hoxhë Migen Matraku

Ramazani është muaji i përkushtimit dhe i agjërimit. Në të besimtari forcon veten e tij në devotshmëri. Për këtë temë dhe ajetet e Kuranit vijnë të tilla në suren Bekare duke filluar me fjalët: **“O ju që besuat, ju është bërë detyrë agjërimit siç ju ishte bërë detyrë dhe atyre që ishin para jush, që ju të jeni të devotshëm.”** (Bekare,183).

Për këtë gjë agjërimit i Ramazanit ka qenë gjithmonë një lloj retrospektive dhe ushtrimi për muslimanin në durimin, moralin dhe diturinë e tij, gjëra të cilat e shoqërojnë atë gjatë gjithë jetës së tij.

Po kështu vijnë dhe hadithet e Profetit a.s. duke shpjeguar kuptimin edukues të agjërimit. Prej këtyre haditheve përmendim transmetimin e Ebu Hurejres r.a. nga Profeti a.s. i cili thotë: *“Ai i cili nuk largohet prej fjalëve e punëve të këqija dhe injorancës, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai të lërë ngrënjen dhe pijen.”* (Buhari:1903,6057) Po kështu përcillet dhe hadithi tjetër i Ebu Hurejres r.a. ku Profeti a.s. thotë: *“Kur të jeni të agjërueshëm gjatë ditës mos flisni gjëra të pista e të ulëta dhe nëse dikush ju ofendon apo ju godet, thoni unë jam agjërueshëm.”* Po në këtë temë transmeton Buhari dhe Muslimi prej Abdullah ibn Mes'udit se Profeti a.s. thotë: *“Nëse keni mundësi të martoheni, martohuni dhe nëse jo, atëherë agjëroni, sepse agjërimit është përulësi.”*

Po kështu agjërimit vjen dhe si shlyerje ndaj gjynaheve siç thuhet në hadith: *“Sprovat që njeriu kalon me familjen, pasurinë dhe fqinjët e tij i shlyen namazi, agjërimit dhe sadekaja.”*

Prej rëndësisë që ka ky adhurim Allahu xh.sh. i ka përgatitur agjëruesve një portë të veçantë për ta në Xhenet të quajtur Rejan. Siç transmeton Buhari dhe Muslimi prej Sehl ibnu Sa'ad r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Në Xhenet është një derë e quajtur Rejan, prej*

saj do të hynë Ditën e Gjykimt vetëm agjëruesit dhe askush tjetër veç tyre. Një zë do thërrasi: “Ku janë agjëruesit?!” Dhe ata do të drejtohen drejt saj e do të futen. Prej asaj dere nuk futet vetëm se ata (agjëruesit) dhe kur të hynë të gjithë agjëruesit ajo derë do të mbyllet e nuk ka për të hyrë në të askush.” Ndërsa në transmetimin e Buhariut hadithi përcillet me këtë tekst: *“Xheneti ka tetë dyer. Njëra prej këtyre tetë dyerve quhet Rejan në të cilën do të futen vetëm agjëruesit.”*

Pra, agjërimit është edukim për muslimanin në jetën e tij. Është ndihmë për të në ato momente kur do të kontrollojë dhe nënshtrijë egon e tij. Po kështu agjërimit është në një pozitë të lartë tek Allahu dhe ky adhurim bën që të hapet për shkak të tij një prej dyerve të Xhenetit.

Nësethemise agjërimit i detyrueshëm është në muajin e Ramazanit, kjo do të thotë se jashtë tij agjërimit është i lejuar përveç dy ditëve të Bajrameve dhe ditës së dyshimit (dita pararendëse e muajit Ramazan). Është i papëlqyeshëm në ditët e teshrikut (dita e dytë, e tretë dhe e katërt e Bajramit të Kurbanit). Po kështu është i papëlqyeshëm agjërimit i ditës së premtë apo të shtunë të vetme pa i shoqëruar ato me një ditë tjetër, qoftë para apo pas tyre.

Agjërimit jashtë Ramazanit ndahet në dy pjesë:

Agjërimit vullnetar dhe agjërimit i detyruar.

AGJËRIMI VULLNETAR:

Ky lloj agjërimit bën pjesë tek ato adhurime të cilat janë shlyese të gabimeve siç e shohim këtë gjë dhe në hadithin e lartpërmedur të Hudhejjes: *“Sprovat që njeriu kalon me familjen, pasurinë dhe fqinjët e tij i shlyen namazi, agjërimit dhe sadekaja.”* Dhe në sahihun e Muslimit në hadithin e Ebu Katade

El-Ensarit r.a. ku Pejgamberi a.s. është pyetur për vlerën e agjërimit të ditës së Arafatit dhe ai thotë: *“Shlyen gabimet e vitit të kaluar dhe vitit që do të vijë.”* Po kështu është pyetur për agjërimitin e ditës së Ashures dhe ai thotë: *“Shlyen gabimet e vitit të kaluar.”*

Në hadithin e transmetuar nga Buhari e Muslimi prej Ebu Seid El-Hadrij r.a. ku ai thotë: Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Çdo besimtar që agjëron një ditë në rrugë të Allahut (për hir të Allahut), Allahu prej kësaj veprë do ta largojë fytyrën e tij nga zjarri i Xhehenemit shtatëdhjetë vjeshta (vjet).”* Në hadithin e transmetuar nga Tirmidhiu prej Ebu Umames r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kush agjëron një ditë në rrugë të Allahut (për hir të Allahut) Allahu do të vendosë midis tij dhe zjarrit një hendek të gjerë, aq sa është gjerësia midis tokës dhe qiellit.”*

Llojet e agjërimit vullnetar:

A- AGJËRIMI I PACAKTUAR

Transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi prej Enesit r.a., i cili thotë se Pejgamberi a.s. e linte agjërimitin gjatë një muaji aq sa mendonim se nuk do të agjërojë më prej atij muaji dhe në një kohë tjetër agjëronte aq shumë sa e mendonim se nuk do ta lërë agjërimitin asnjë ditë. Po kështu transmetohet nga Buhariu e Muslimi në hadithin e Ibnu Abasit r.a. që thotë se Pejgamberi a.s. asnjëherë nuk ka agjëruar një muaj të plotë përveç se muajin e Ramazanit. E kur agjëronte, e vazhdonte agjërimitin deri sa thonim: *“Pashim Allahun nuk do ta lërë më dhe kur nuk agjëronte e linte atë deri sa thonim: “Për Allahun, nuk do agjërojë më.”*

B- AGJËRIMI I CAKTUAR

1-Agjërimit i ditës së Ashures: Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa El-Esh'arij r.a. i cili thotë: *“Dita e Ashures ka qenë ditë e shenjtë për hebrenjtë dhe ata e festonin atë ditë, ndërsa neve Pejgamberi a.s. na tha: “Ju agjërojeni këtë ditë.”* Në transmetimin e Muslimit Ibnu Abasi r.a. thotë: *“Kur Pejgamberi a.s. e agjëroi Ditën e Ashures e u tha dhe të tjerëve ta agjëronin atë ditë. Disa prej të pranishmëve i thanë: “O i Dërguari i Allahut, kjo ditë është e shenjtë për hebrenjtë dhe të krishterët!”* Pejgamberi a.s. u tha: *“Nëse do ta arrijmë vitin që vjen do ta agjërojmë bashkë me ditën e nëntë.”* Viti që pasoi ishte viti ku Pejgamberi a.s. vdiq.

2- Agjërimit i ditës së Arafatit: Muslimi transmeton nga Ebu Katade r.a. që thotë: *“Pejgamberi a.s. është pyetur për vlerën e agjërimit të ditës së Arafatit dhe tha: “Shlyen gabimet e vitit të kaluar dhe vitit që do të vijë.”* Po kështu është pyetur për agjërimitin

e ditës së Ashures dhe tha: *“Shlyen gabimet e vitit të kaluar.”*

3-Agjërimit i gjashtë ditëve në muajin Sheual: Muslimi transmeton nga Ebu Ejub El-Ensarij r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Ai që agjëron Ramazanin dhe më pas atë e pason me agjërimitin e gjashtë ditëve të Sheualit do të jetë për të (në shpërblim) sikur të ketë agjëruar të gjithë jetën.”*

4-Agjërimit i dhjetëditëshit të parë të muajit Dhul Hixheh: Ebu Daudi dhe Nesaiu transmetojnë prej Hunejd ibnu Halid se një grua shkoi tek Umu Seleme (gruaja e Pejgamberit a.s.) dhe dëgjoi atë që thoshte: *“I Dërguari i Allahut a.s. agjëronte nëntë ditët e para të Dhul Hixhes dhe tre ditët e çdo muaji: të hënën e parë të muajit dhe dy të enjte.”*

Buhariu transmeton prej Ibnu Abasit r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Ditët që Allahu i do më shumë punët e mira janë këto ditë (dhjetë ditët e Dhul Hixhes).”* I thanë: *“O i Dërguari i Allahut, edhe xihadi në rrugë të Allahut, edhe xihadi në rrugë të Allahut, përveç atij i cili shkon në luftë me pasurinë e tij e nuk kthehet prej saj (bie dëshmor).”*

5-Agjërimit i muajit Muharrem: Muslimi transmeton prej Ebu Hurejres r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Agjërimit më i mirë pas Ramazanit është agjërimiti i muajit Muharrem dhe namazi më i mirë mbas farzit është namazi i natës.”*

6-Agjërimit i muajit Shaban: Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Aishja r.a. se ka thënë: *“I Dërguari i Allahut brenda një muaji më së shumti agjëronte në Shaban, aq sa ai e agjëronte atë pothuajse të gjithin.”* Nesaiu transmeton prej Usame ibnu Zejdut r.a. i cili thotë: *“I thashë të Dërguarit të Allahut a.s.: “O i Dërguari i Allahut! Të shoh që më shumë agjëron në Shaban sesa gjatë muajve të tjerë.”* Tha: *“Ky muaj është neglizhuar prej njerëzve duke qenë se është midis Rexhebit e Ramazanit. Ky është muaji që veprat tona ngrihen tek Zoti i gjithësisë dhe dua që kur të ngrihen punët e mia tek Zoti të jem i agjërueshëm.”*

7-Agjërimit i ditëve javore: Nesaiu, Tirmidhiu dhe Ibnu Maxheh transmetojnë prej Aishes r.a. se i Dërguari i Allahut a.s. agjëronte ditën e hënës dhe ditën e enjte.

8-Agjërimit i ditëve të bardha të çdo muaji: Nesaiu transmeton prej Melhanit që thotë se i Dërguari i Allahut a.s. na urdhëronte të agjëronim ditët e bardha të trembëdhjetën, të katërmbëdhjetën dhe të pesëmbëdhjetën (të muajit hënor). Tha: *“Agjërimiti i tyre është si të agjërosh pa ndërprerje.”*

LSHH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Jurisprudencë/ DISPOZITAT E FALIMENTIMIT NË ISLAM

I falimentuar quhet ai person apo subjekt fizik dhe juridik i cili ka më shumë borxhe se kapitali që ka në dispozicion. Nëse kreditorët (ata që kanë dhënë borxhin) kërkojnë nga autoritetet përkatëse që të sekuestronin pasurinë e të falimentuarit dhe ta ndajë pasurinë e tij mes tyre, në këtë rast autoritetet e kanë për detyrë që t'u përgjigjen thirrjes së tyre. Shejh Salih el Feuzan, duke sqaruar dispozitat e sekuestrimit të pasurive dhe falimentit thotë:

1- “Sekuestrimi sipas legjislacionit islam do të thotë ndalimi i të drejtës së të falimentuarit për të vepruar në pasurinë e tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: **“E mos ia jepni mendjelehtëve pasurinë tuaj, të cilën Allahun e ka bërë shtyllë (të jetës). Ushqejini ata prej asaj pasurie dhe vishini ata, dhe thuajuni atyre fjalë të mira. Provojini jetimët dhe kur ata të keni mbërritur moshën e pjekurisë, nëse vereni prej tyre ndonjë shenjë pjekurie, atëherë mund t'ua jepni atyre pasurinë e tyre.”** (En-Nisa; 5, 6).

Këto dy ajete tregojnë se pasuria mund t'i privohet mendjelehtët dhe jetimit në mënyrë që të mos e shpërdërojnë atë dhe se rikthimi i saj mund të bëhet vetëm atëherë kur ata të jenë të ndërgjegjshëm dhe të pjekur në veprimet e tyre me pasurinë. I dërguari i Allahut a.s. e ka bllokuar pasurinë e disa sahabëve në mënyrë që prej saj të shlyheshin borxhet që u kishin të tjerëve.

2- Sekuestrimi apo bllokimi i pasurisë është dy llojesh:

Lloji i parë është sekuestrimi i pasurisë në interes të palëve të tjera, si p.sh. sekuestrimi i pasurisë së falimentuarit, i cili posedon një sasi pasurie që nuk mjafton për të shlyer borxhet e të tjerëve dhe në këtë mënyrë ai ndalohet që të veprojë me pasurinë e tij në mënyrë që të mos dëmtojë pasurinë e të tjerëve.

Lloji i dytë është borxhliu i cili nuk arrin të shlyejë borxhet. Këtij nuk i kërkohej që të kthejë borxhin, por duhet që t'i jepet kohë derisa të jetë në gjendje të shlyejë borxhin e vet. Allahu i Lartësuar thotë: **“E nëse është në vështirësi, atëherë le të pritë derisa të vijë koha e lehtësimit.”**

Ndërsa përse i përket personit që ka mundësi ta shlyejë borxhin, pasuria e tij nuk lejohet që të sekuestronin sepse kjo është e panevojshme, por ai urdhërohet që të shlyejë borxhet që ka përsipër nëse i zoti i borxhit e kërkon diçka të tillë. Argument për këtë është fjala e të dërguarit të Allahut: **“Vonimi i borxhit prej atij që ka mundësi ta shlyej atë është padrejtësi”,** që do të thotë se moslyerja e borxhit duke pasur mundësi për ta bërë këtë është padrejtësi, për arsye se ka penguar shlyerjen e një të drejtë që u takon njerëzve. Nëse nuk pranohet që ta shlyejë borxhin pavarësisht se ka mundësi që ta bëjë këtë, atëherë ai burgoset.

Shejh Ibn Tejmijeh thotë: “Nëse dikush është në gjendje për ta shlyer borxhin dhe nuk pranohet që ta shlyejë atë, atëherë ai detyrohet që ta shlyejë edhe nëse goditet apo burgoset. Për diçka të tillë janë dekluar disa imamë ndjekës të Malikut, Shafiut, Ahmedit etj.” Më pas ai shprehet: “Për diçka të tillë nuk di që të ketë mospajtime.”

I dërguari i Allahut a.s. thotë: **“Kush vonon shlyerjen e borxhit i bëhet hallall që të përçmohet dhe të ndëshkohet.”** E përcjell Ahmed, Ebu Daudi etj. Pra borxhliu që refuzon të shlyejë borxhin dhe hakun e të tjerëve e meriton që të ndëshkohet dhe burgoset. Ky dënim mund t'i përsëritet derisa të shlyejë borxhin, por nëse këmbëngul atëherë mund të ndërhyet duke e shitur pasurinë e tij në mënyrë që prej saj të shlyhet borxhi që rëndon mbi të, në mënyrë që riparohet dëmi që i është shkaktuar borxhdhënësve. I dërguari i Allahut a.s. thotë: **“As mos dëmto dhe as mos u bëj shkak për dëm.”**

4- Nga sa u përmend është e qartë se borxhlinjtë janë dy llojesh:

a- Kur borxhi ka një afat dhe si pasojë atij nuk i kërkohej që ta shlyejë borxhin derisa të plotësohet afati. Nëse posedon pasuri më pak se detyrimi i borxhit me afat, atëherë pasuria e tij nuk konfiskohet dhe ai nuk pengohet që të veprojë me pasurinë e tij.

b- Kur pasuria është më e pakët se borxhi që i është mbushur afati pasuria e borxhliut konfiskohet dhe ndalohet që të veprojë me të, nëse debitorët (të zotët e borxhit) e kërkojnë diçka të tillë. Argument për këtë është hadithi i përcjellë nga Ka'ab bin Maliku r.a. që përcjell se i dërguari i Allahut a.s. e konfiskoi (bllokoi) pasurinë e Muadhrit r.a. dhe e shiti pasurinë atij.” E përcjell Dar el Kutni dhe Hakemi që e vlerëson si të saktë.

Ibn Salahu thotë: “Ky është një hadith i saktë dhe në këtë rast konfiskimi shpallet dhe u bëhet njerëzve me dije se këtij borxhliu i është bllokuar pasuria në mënyrë që njerezit e tjerë të mos joshen prej tij dhe të mos kenë marëdhënie me të. Në këtë mënyrë pasuria e tyre nuk shkon dëm.”

5- Katër dispozita lidhen me konfiskimin:

1- Me konfiskimin lidhen të drejtat e debitorëve me pasurinë e borxhliut përpara se të ndodhë konfiskimi, si dhe me pasurinë e borxhliut pas konfiskimit. Ibn Kajjimi thotë: “Nëse borxhet e tejkalojnë pasurinë e tij, atëherë nuk bën që ai të japë sadeka duke dëmtuar kështu pasurinë e kreditorëve, pa marrë parasysh nëse autoritetet ia kanë konfiskuar apo jo pasurinë. Ky është medh'hebi i Malikut dhe mendimi i përzgjedhur i shejhut të Islamit Ibn Tejmijes – Allahu e mëshiroftë.

2- Kush e gjen mallin e tij të cilin ia ka shitur të falimentuarit apo që ia ka dhënë borxh apo me qera përpara se të kryej konfiskimi, ka të drejtën që ta

marrë mallin e tij prej të falimentuarit me argument fjalën e të dërguarit të Allahut a.s.: **“Kush e gjen mallin e tij tek njeriu i falimentuar e meriton që ta marrë atë më shumë se të tjerët.”** Buhariu dhe Muslimi. Dijetarët kanë përmendur se për rikthimin e mallit nga i falimentuari duhen plotësuar gjashtë kushte:

a- I falimentuari duhet të jetë gjallë deri në momentin që i merret pasuria. Argument për këtë është hadithi i përcjellë tek Ebu Daudi se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: **“Dhe nëse vdes, të zotët e mallit janë grupi i atyre që kërkojnë borxhin.”**

b- Vlera e gjithë mallit duhet të jetë detyrim i borxhliut dhe nëse i zoti i mallit ka arritur që të marrë një pjesë të vlerës së mallit nuk i takon që ta rimarrë atë.

c- Malli konkret të jetë i tëri në pronësi të borxhliut dhe nëse gjendet vetëm një pjesë e mallit, atëherë i zoti i tij nuk e merr, sepse nuk ka gjetur gjithë mallin e tij, por vetëm një pjesë.

d- Malli të jetë në gjendjen e mëparshme, pa u ndryshuar asgjë prej karakteristikave të tij.

e- Me mallin nuk të lidhen të drejta të të tretëve, si p.sh. nëse borxhliu e ka lanë mallin peng tek dikush tjetër.

f- Malli nuk duhet të shtohet në mënyrë natyrale, si p.sh. shëndoshja e kafshës.

Nëse plotësohen këto kushte, atëherë i lejohet të zotit të mallit që ta rimarrë atë nga borxhliu i falemintuar, sipas hadithit të lartëpërmendur.

3- E drejta për t'i kërkuar borxhin pas konfiskimit ndërpritet deri në momentin që borxhliu të lirohet nga konfiskimi. Si rrjedhojë, kush i shet apo jep borxh borxhliut diçka gjatë kësaj

periudhe mund ta kërkojë të drejtën e tij vetëm pas lirimit të pasurisë së tij nga konfiskimi.

4- Autoritetet kanë të drejtën që të sheshin mallin e konfiskuar nga i falimentuari dhe ta shpërndajnë të ardhurat prej tij mes kërkuesve të borxhit, sepse kjo është edhe arsyeja e kryerjes së konfiskimit të pasurisë së borxhliut. Nëse kjo shpërndarje vonohet, atëherë ajo përbën padrejtësi, ndërkohë që autoritetet kanë të drejtë që t'i lejnë borxhliut aq pasuri që mund t'i mjaftojë për strehim, ushqim etj.

Përse i përket borxhit me afat, ato nuk mund të shlyhen përmes shpalljes së falimentimit dhe as nuk mund të përzihen me borxhet që e kanë mbushur afatin, për arsye se afati është një e drejtë që i takon borxhliut të falimentuar, ashtu siç gëzon të gjitha të drejtat e tjera dhe borxhi mbetet në garancinë e tij. Nëse borxhliu, pas shpërndarjes së borxhit që ka mbushur afatin tek kërkuesit e borxhit i shlyen të gjitha dhe nuk mbetet asgjë për të kthyer, atëherë sekuestrimi shfuqizohet, qoftë edhe pa një vendim nga autoritetet. Nëse i mbetet ndonjë borxh që ka mbushur afatin pa shlyer, atëherë sekuestrimi shfuqizohet vetëm me vendim nga autoritetet, sepse ato kanë urdhëruar më parë sekuestrimin e pasurisë së tij.” (Përmbledhje e Fikhut 2/89-95) Nëse mbeten përsëri disa borxhe për t'u shlyer, ato mbeten në garancinë e borxhliut deri në momentin që Allahu ta furnizojë me pasuri dhe në këtë moment ai e ka për detyrë që të shlyejë këto borxhe të mbetura.

Allahu e di mëse miri.

<http://islamqa.info/ar/145437>

Përktheu: hoxhë Genc Plumbi

Hadithe rreth respektimit të fqinjët

• Nga Ebu Shurejh el-Huzaiu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu uesselam) ka thënë: **“Kush ka besuar Allahun dhe ditën e gjykimit le t'i bëjë mirë fqinjët të tij. Kush ka besuar Allahun dhe ditën e gjykimit le ta respektojë mikun e tij. Kush ka besuar Allahun dhe ditën e gjykimit le të flasë të mirën ose të heshtë.”** Transmetuan Buhariu dhe Muslimi .

• Në një version tjetër që e shënon Buhariu thuhet: **“Kush ka besuar Allahun dhe ditën e gjykimit le ta respektojë fqinjin e tij.”**

• Nga Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre dyve) përcillet se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu uesselam) ka thënë: **“Xhibrili gjithnjë më porosiste t'i bëj mirë fqinjët sa që mendova se ai do ta konsideronte atë si trashëgimtar.”** Transmetuan Buhariu dhe Muslimi .

• Nga Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu uesselam) ka thënë: **“O Ebu Dherr! Kur të gatuash gjellë shtoja lëngun dhe kërko te fqinjët e dërgoji dhe atyre.”** Transmetoi Muslimi .

• Nga Ebu Shurejhi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu uesselam) ka thënë: **“Pasha Allahun nuk beson, pasha Allahun nuk beson.”** E pyetën: **“Cili o i Dërguari i Allahut?”** Ai tha: **“Ai njeri nga të këqijat e të cilit nuk janë të sigurtë fqinjët e tij.”** Transmetoi Buhariu

Gruaja/ GRUAJA NËNË, MODERNITETI DHE EDUKIMI I FËMIJËVE

Nga hoxhë Justinian Topulli



Gruaja, kjo qenie të cilën Zoti e ka krijuar për të qenë mbi të gjitha nënë. Në të gjitha krijesat e gjalla që Ai ka krijuar funksionin kryesor që ajo kryen është të qenit nënë. Edhe pse bota e gjallesave të tjera është shumë e ndryshme nga ajo e njeriut, përsëri ky funksion i rëndësishme jetësor ngelet i njëjtë.

Të mbartësh për nëntë muaj në bark një njeri, duke e ushqyer atë nga gjaku, mishi dhe trupi yt, duke prishur rehatinë dhe përkeqësuar shëndetin është një stërmundim që vetëm gratë e pranojnë. Ta lindësh atë duke duruar dhimbjet e mëdha dhe rrezikuar shpesh edhe jetën, është një sfidë që vetëm gratë përballen me të. Ta ushqesh fëmijën, ta lashë atë, ta veshësh dhe të kujdesesh për të sa herë që ai ka nevojë, është një lodhje që vetëm gratë nëna e durojnë. Ta rrisësh dhe ta edukosh fëmijën derisa të bëhet i aftë për vetveten, është një sakrificë e vështirë që vetëm gratë nëna e ofrojnë. T'i falësh fëmijës dashuri, dhembshuri, ngrohtësi dhe mëshirë gjatë gjithë këtij procesi të gjatë, të vështirë dhe sflitës, është një mrekulli që vetëm gratë nëna mund ta bëjnë... Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, gruas në shtëpinë e burrit i duhet të jetë edhe amvisë që mirëmban dhe kujdeset për të pa marrë asnjë rrogë për këtë shërbim.

Nëse do të kërkoje në botë dikë që të gjitha këto t'i bënte kundrejt një pagese, edhe nëse do të pagoje me miliona, vështirë se do të gjeje një njeri që do t'i bënte të gjitha këto së bashku, ashtu siç i bën gruaja nënë. Edhe nëse do të gjeje një njeri të tillë, ajo çka do të bënte ai nuk do të ishte për shkak të parasë, sepse nuk ka para që t'i blejë të gjitha këto gjëra së bashku, por për shkak të një ndjenje përgjegjësie që nuk e ka burimin te paraja.

Të gjitha këto së bashku, më mirë se kushdo tjetër i bën gruaja nënë pa asnjë pagesë, për fëmijët, pasardhësit dhe burrin e saj. Kështu pra shërbimi i nënës nuk ka të paguar, as rroga e babait dhe as gjithë pasuria e tij nuk mundet ta paguajnë këtë hyzmet që ajo bën. Edhe pse jetojmë në kohën ku mendohet se çdo gjë mund të blihet dhe shitet me para, mes të tjerash edhe

ky shërbim, ajo çfarë bën gruaja nënë është shumë më e shtrenjtë se çdo para, dhe praktikisht nuk vlerësohet dot vetëm me të holla.

Pikërisht për të gjitha këto, sipas fesë islame, kompensimi që i detyrohet fëmija nënës së tij është tre herë më i madh se për babain. Ndaj kush thotë se të mirat materiale që burri i siguron familjes së tij, kanë më tepër duk dhe më shumë vlerë sesa puna e papaguar dhe gjoja e paduk e gruas nënë në shtëpi, absolutisht që e ka gabim. Së pari kjo është një vështrim tejet materialist i familjes, që i vlerëson marrëdhëniet familjare burrë grua fëmijë vetëm me vlerën e dukshmërisë materiale dhe parasë. E dyta, edhe nëse ky shërbim do të paguhej, faktikisht, vlera e tij do të ishte shumë më madhe sesa paguhen në realitet shërbyeset që e bëjnë këtë punë për të holla. Kështu pra, puna e gruas nënë në shtëpi ka një kosto dhe vlerë edhe ekonomike mjaft të madhe, krahas asaj shpirtërore, edukative dhe emocionale që nuk vlerësohet dot me të holla. Pra ajo mbart krahas të tjerash edhe një peshë financiare për familjen dhe shoqërinë dhe u kursen atyre miliarda. Dhe natyrisht pikërisht për këtë shërbim kaq të madh që nuk vlerësohet në para ajo më shumë se për to ka nevojë për respekt, për durim dhe përkujdesje, sidomos nga ata për të cilët ajo është e gatshme të sakrifikojë edhe jetën e saj.

Vlerësimi vetëm material dhe kryesisht i tillë është një vlerë – nëse mund të quhet e tillë – të cilën njerëzimi e ka adoptuar në masë të madhe vetëm në epokën moderne. Madje edhe fama, prestigji individual dhe etja për të bërë diçka, që të shihet dhe vlerësohet nga sa më shumë njerëz, është produkt i egos materialiste që epoka moderne ua ushqen njerëzve me të gjithë përbërësit e saj të veçantë. Dhe absolutisht që të prekurit nga pasojat negative të modernitetit janë edhe burrat edhe gratë, njëlloj.

Perioda e revolucionit industrial në shek. XIX dhe nevoja për krah të lirë pune, sidomos në kohë krizash dhe lufte, i shtyu sipërmarrësit kapitalistë që të punësonin me shumicë gra e fëmijë të rritur në fushën e prodhimit, duke qenë se ata mund ta bënin punën njëlloj dhe mund të paguheshin më pak, duke shfrytëzuar natyrisht nevojën ata që kishin për të holla. Orët e gjata që prindërit, apo edhe vëllezërit dhe motrat e rritur kalonin në punë, krijonin problemin për kujdesin ndaj fëmijëve të vegjël, që nuk mund të lireshin të vetëm në shtëpi. Kështu p.sh. në Britaninë e Madhe më 1816 Robert Owen, pronari i një manufakture pambuku, qe ndër të parët që ideoi dhe praktikoi si zgjidhje për punëtorët e biznesit të tij një kopsht fëmijësh. Natyrisht me rritjen dhe shtrirjen e revolucionit industrial

edhe në pjesët e tjera të botës do të përhapeshin edhe idetë dhe praktikatat që shoqëronin dhe mbështesin këtë revolucion.

Edhe pse kjo është diçka e njohur për një pjesë të njerëzve, është e nevojshme të përmendet për të sqaruar se si fillesë nuk qe nevoja e edukimit dhe shoqërizimit të fëmijëve, ajo që i shpiku çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve, sepse fëmijëve nuk u mungonin këto gjëra, por qe nevoja e revolucionit industrial për të siguruar sa më shumë krah të lirë pune, ai që nxori gruan nënë nga shtëpia dhe çoi fëmijët të rriteshin dhe edukoheshin jashtë gjirit të familjes nga të tjerët. Sot natyrisht janë gjetur edhe mjaft arsye të tjera që përligjin vazhdimësinë e edukimit të fëmijëve jashtë familjes, por në thelb revolucioni industrial mbetet ai që nxori për herë të parë gruan nga puna “e papaguar” e shtëpisë në punët me mëditje jashtë saj. Që ky proces të ndodhte edhe në shoqëritë tradicionale, duhej që të ndryshonte mentaliteti i njerëzve. Natyrisht këtë nuk mund ta bënte vetëm nevoja materiale e njerëzve, pasi kultura dhe zakonet shpesh janë aq të fuqishme saqë paradigma marksiste se njeriu motivohet vetëm nga realiteti dhe interesi material praktikisht në këtë rast nuk vlen. Pra, nevojitej propaganda dhe përhapja e ideologjive të reja. Kështu pra – krahas shkaqeve dhe arsyeve të tjera – lindi edhe i ashtuquajtur i emancipim i gruas, që natyrisht shfrytëzoi për efekt propagande emocionale dhe racionale mjaft mirë problemet që kishin shoqëritë tradicionale në lidhje me trajtimin e grave. Sa për amplifikimin dhe fryrjen e tyre nuk ia vlen të zgjatemi, sepse kjo shihet edhe sot, nga sulmet që i bëhen shpesh shoqërive tradicionale islame ose jo nëpër botë si të prapambetura dhe të dhunshme! Sot emancipimi i gruas është kthyer në një aspiratë dhe ideal që e ka humbur lidhjen me premisat dhe kushtet fillestare kur ai lindi dhe është bërë pjesë e një ideali tjetër që njihet si të drejtat e njeriut apo ideali i barazisë gjinore në çdo gjë.

Në shoqëritë materialiste, qofshin këto socialiste apo kapitaliste, e sidomos në këto të sotmet konsumersite, ku lumturia e njeriut vlerësohet dhe edukohet vetëm dhe kryesisht tek mirëqenia ekonomike, gruaja nënë ashtu si edhe burri është vegël pune dhe mjet për të siguruar këtë mirëqenie. Por jo vetëm kaq, arritja individuale e një njeriu, në mentalitetin e sotëm, nuk vlerësohet ajo që ai bën për fëmijët, bashkëshortin dhe familjen e tij, kjo është shumë pak (!), por çfarë ai bën në radhë të parë vetëm për veten e tij dhe në radhë të dytë çfarë ai bën për shoqërinë në përgjithësi edhe pse për familjen e tij mund të bëj shumë pak ose asgjë. Nëse

shih sot më shumë njerëz sesa dikur të mos kujdesen për prindërit e tyre, ose edhe për vëllezërit dhe motrat, edhe mes besimtarëve, kjo padyshim që është pasojë e modernitetit, e mbi të gjitha e edukimit të mangët ose mungesës së tij. Nëse një brez i tërë njerëzish që është rritur dhe edukuar deri dje nëpër çerdhe dhe kopshte dhe sot është tërë kohën i preokupuar me rendjen pas parasë, punës apo edhe pasionit dhe argëtimit, nuk është aspak e habitshme pse gjen me shumicë mes tyre të mos kujdesen dhe interesohen për prindërit apo të afërmit e tyre. Ata që edukohen “në gjirin e shoqërisë” më shumë se në gjirin e familjes, nuk kanë sesi t'i përkushtohen asaj më shumë seç kanë marrë prej saj. Sa të marrësh aq edhe do të japësh, ky ligj rrallë gjen përjashtime.

Kështu pra edukimi i fëmijëve të sotëm ka marrë këtë rrugë, ai është një edukim që çuditërisht mund të ofrohet dhe blihet me para, në kopshte apo jashtë tij. Kështu që nëse lumturia dhe kënaqësia në këtë botë për çdo individ qëndron tek mirëqenia materiale dhe lidhet me të, atëherë të kthehesh tek format e shoqërive tradicionale të dikurshme, që e konsideronin dhe e edukonin si të pavolitshme daljen e gruas nga shtëpia dhe edukimin e fëmijëve jashtë saj, është diskriminim dhe shkelje e të drejtave të njeriut! Apo për disa edhe ndryshe, pengesë që devijon apo frenon progresin e evolucionit shoqëror të njerëzimit! Për ku? Padyshim drejt utopisë së parajsës tokësore!

T'i kundërvihesh këtyre pasojave negative të modernitetit në mënyrë radikale dhe të menjëhershme, jo vetëm që është e pamundur, por edhe me rrjedhoja negative për vetë njerëzit dhe komunitetin që i ndërmerret të tilla iniciativa. Por, të ndryshosh për mirë qoftë edhe për një kohë të gjatë nuk është asnjëherë e pamundur. Ajo për të cilën ne kemi nevojë fillimisht, është t'ia nisim së paku nga rritja dhe edukimi tradicional i fëmijëve, në gjirin e familjes, ku me dashuri, dhembshuri dhe durim krahas kujdesit trupor dhe shëndetësor për ta duhet t'i kushtohet më tepër rëndësi edhe formimit të tyre shpirtëror, mendor dhe intelektual, dhe këtë përgjegjësi tepër të madhe askush më mirë se prindërit dhe gruaja nënë nuk mund ta kryejnë. Ky nuk është kthim tek të ashtuquajturat forma të shtypjes dhe skllavërisë së gruas, por kthim tek vlerat e besimit, tek natyrshmëria që Zoti e ka krijuar njeriun. Edhe pse dihet që një proces i tillë nuk është aspak i lehtë dhe i shkurtër, ai është një hap i domosdoshëm për ndryshimin e gjendjes aspak të kënaqshme ku ndodhemi sot ne si shoqëri.



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e lindjes!

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
 Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
 Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
 Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
 Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
 Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
 Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
 Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
 Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
 Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
 rrugica përballë
 xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
 Cel: 0672812607 / 0672821589

www.produktenatyrale.com
 Email: agimballa@hotmail.com



**SHKOLLA JOPUBLIKE
 HAFIZ IBRAHIM DALLIU**

Përveç djes, ne edukojmë

UNAZA
 Blloku Spitaleve
 Rruga Bardhyl
 Rruga "4 Dëshmorët"
 Kopshti 35
 Shkolla "4 Dëshmorët"

Për regjistrime kontaktoni në:
066 57 74 718 068 58 27 868
 e-mail: shkollaibrahimdalliu@hotmail.com

**SHKOLLA JOPUBLIKE
 HAFIZ IBRAHIM DALLIU**

5 JETIMËT E PARË
 QË REGJISTROHEN
 PËR ÇDO KLASË
 PËRFITOJË STUDIME
 FALAS

Përveç djes, ne edukojmë

Për regjistrime kontaktoni në:
066 57 74 718 068 58 27 868